



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

C.nr.995/19

C.nr.1295/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL, gjyqtari Burim Emërllahu ,në çështjen juridike të paditësit I.R ,nga Ferizaji,rr... p.nr.,të cilin në bazë të autorizimit e përfaqësonë avokati R.S ,nga Ferizaji,... pa nr,kundër të paditurës B... ,me seli në Prishtinë,të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson D.H ,baza juridike kompenzim dëmi,me datë 24.01.2020 ,mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar kërkespacia e paditësit I.R ,nga Ferizaji dhe **DETYROHET** e paditura B..., me seli në Prishtinë që paditësit I.R ,nga Ferizaji t'ia paguaj shumat si në vijim:për dhimbjet e përjetuara fizike ,shumën prej 2000 euro,për frikën e përjetuar ,shumën prej 1800 euro , në emër të shpenzimet mjekësore 58.80 euro,për dëmtimin e motoqikletes 424.50 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data e paraqitjes së padis e deri në pagesën përfundimtare.

II.DETYROHET e paditura B..., me seli në Prishtinë , që paditësit I.R, nga Ferizaji në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tia paguaj shumat si në vijim :për ekspertizë të makinerisë ,shumën prej 100 euro,për ekspertizë mjekësore shumën prej 200 euro ,për përfaqësim në dy seanca gjyqësore ,shumën prej 270 euro, për hartimin e padis,shumën prej 104 euro.

III. Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadis së paditësit I.R ,nga Ferizaji, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që detyrohet e paditura B..., me seli në Prishtinë që paditësit I.R tia paguaj shumat si në vijim: për ushqim të përforcuar ,shumën prej 200 euro, për ndihmën e personit të tretë ,shumën prej 100 euro, për rehabilitim fizi klimaterik ,shumën prej 260 euro, në emër të shpenzimet mjekësore ,shumën prej 11.20 euro, në emër të dhimbjeve fizike 3000 euro, për frikën e përjetuar 1200 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data e paraqitjes së padis e deri në pagesën përfundimtare.

A r s y e t i m

Paditësi I.R ,nga Ferizaji, ka parashtruar padi në këtë gjykatë ,kundër të paditurës B..., me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi.

Nga thënjet e palës paditëse rezulton se pala paditëse padin e bazon në arsyen se me datën 31.03.2019 ,ka ndodhur një aksident i komunikacionit rrugor rrugorë, të cilin e ka shkaktuar B.S ,me përdorimin e automjetin të udhëtarëve "Mercedes" ML350, me targa të regjistrimit të Zvicrrës ..., dhe si pasojë e këtij aksidenti paditësi I.R ka pësuar dëm material dhe jomaterial.

E paditura në lidhje me qështjen kontestuese në përgjegje në padi ka theksuar: nuk e kontestojmë legjitimitetin pasiv e as bazën juridike të kërkesëpadis për sa i përket rrjedhes së ngjarjes deri te aksidenti. Marrë parasysh faktin se e paditura është e interesuar që këtë kontest ta zgjidhë me marrëveshje ,ashtu që për dëmin material në automjet ,sipas vlerësimit të dëmit ofrojmë shumën prej 150 euro. Në qoftëse paditësi nuk pajtohet me shumën e ofruar atëherë të njejtin e ftojmë të prezantojë faturat fiskale të riparimit të motoqikletës ,apo motoqikletën ta sjellë për riparim tek serviset e autorizuara sipas rekomandimit të BKS-së. Për sa i përket lëndimeve trupore për të gjitha format e dëmit nga ky aksident paditësit i ofrojmë shumën prej 950 euro. Në qoftëse paditësit nuk pajtohet me shumën e ofruara ,të njejtin e ftojmë që të prezantojë prova për dëmin e pësuar.

Përfaqësuesi i të paditurës B.... D.H në seancë gjyqësore ka theksuar: kundërshtojmë precizimin e kërkesë padisë, shumën e kërkuara janë tejjet e larta, dhe nuk janë në harmoni me lëndimet e paditësit,. Mbesim pranë ofertave që i kemi dhënë në seancat e kaluara, dhe i propozojmë gjykatës, që përtej shumave të ofruara, në ofert, shumën tjera të kërkuara ti refuzoj si të pa bazuara. Kamatën ta caktoj gjykata nga koha e nxjerjes së aktgjykimit në lartësi e normës bankare që bankat komerciale e paguajnë për mjetet e deponura mbi një vit pa destinim të caktuar, dhe shpenzimet të i caktoj në përputhje me suksesin e arritur në realizimin e kërkesës së palëve në procedurë.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje civilo juridike janë administruar si provë: raporti policor i aksidentit i dt. 31.03.2019. nr. CFT -131, kuponat fiskal, i dt. 19.06.2019, nr. 2, i lëshuar nga shërbimi ambulantor Neurokirurgia, kuponi fiskal, i dt. 05.04.2019, i lëshuar nga "O..." NTP Njësia Ferizaj, kuponat fiskal id t. 31.05.2019, me numër 0010 i lëshuar nga P..." SHPK Ferizaj, kuponi fiskal nr. 0009 i dt. 31.05.2019, i lëshuar nga "P..." SHPK Ferizaj, kuponi fiskal i dt. 15.06.2019, i lëshuar nga "D..." NTP, në Ferizaj, kuponi fiskal i dt. 17.09.2019 nr. 11, i lëshuar nga Noteri H.H, ekspertiza e vlerësimit të dëmit e dt. 09.12.2019. ekspertiza mjekësore e dt. 23.11.2019.

Gjykata pasi vlerësoi provat e administruara dhe deklaratat e palëve ndërgjyqëse të dhëna nëpërmes të autorizuarve të tyre vërtetoi këtë gjendje faktike:

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues ekzistimi i fakti se me datën 31.03.2019 ka ndollur një aksident i komunikacionit rrugor ,të cilin e ka shkaktuar Beqir Bislimi ,me përdorimin e automjetit të udhëtarëve "Mercedes"ML350,me targa të regjistrimit të Zvicrrës ...

Kurse e paditura nuk e ka kontestuar legjitimitetin pasiv të sajë e as bazën juridike të kërkesëpadis për sa i përket rrjedhes së ngjarjes deri te aksidenti.

Kurse edhe në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia pala në këtë rast konkret për kompensim dëmi ka të drejtë të parashtroj kërkesë te e paditura.

Me leximin e ekspertizës mjekësore të hartuar nga mjekët: dr. Halit Gërbeshi ortoped traumatolog, dr. M.A psikiatër gjykata ka vërtetuar se paditësi I.R si pasojë aksidentit të datës 31.03.2019 ka pësuar dëmtime të lehta trupore si dhe : dhimbje fizike me intensitet të rëndë 3 ditë kjo për shkak të pozitës shumë ndjeshme në nivel të kërcit ,i cili është dobët i mbuluar me muskuj ,pra nga presioni madh i homorragjisë ,e cila vjen nga vaslularizimi i këtyre indeve ,të cilat mund të riaktivizohen në tre katër ditët e para pas lëndimit.Dhimbje fizike me intensitet të mesëm 14 ditë kohë e domosdoshme për rifillimin e indeve në gjendjen-formën e mëparshme si përthithja e hematomes dhe ulja e edemave për rreth indeve të shkaktuara nga haematoma të cilat shkaktojnë ngacmime të nervave periferik nga presioni që shkojnë mbi mbi ta duke dhënë dhimbje.Dhimbje të intenzitetit të lehtë 35 ditë të cilat riaktivizohen dhe bëhen bezdisëse në ndryshime të pozicionimit sidomos gjatë vertikalizimeve të gjata në sforcime fizike të muskujve lokal.Ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar 21 ditë,për ndihmë dhe kujdesin nga personi tretë 7 ditë .Ka pasur nevojë për Rehabilitim Fizi-Klimaterik 10 ditë.

Me leximin e ekspertizës mjekësore të hartuar nga mjekët: dr. Halit Gërbeshi ortoped traumatolog, dr. M.A psikiatër gjykata ka vërtetuar se paditësi I.R si pasojë aksidentit të datës 31.03.2019 ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatë

3 ditë si gjendje akute në stres e që është manifestuar me ankthe të natës dhe zgjime të shpeshta nga gjumi, me shqetësim, reaksione emocionale, funksionalitet i rën me parahati nga rikujtimet aksidentit. Pas kësaj frika kalon në: Frikë sekondare të intensitetit të mesëm që zgjatë dy javë tjera gjatë të cilës kohë është preokupuar me gjendjen shëndetësore të krijuar pas aksidentit dhe vështërsitë për tu adoptuar me këtë gjendje. Kjo gjendje është përcjellë me simptoma të frikës, me reduktim të aktiviteteve ditore për shkak të rikujtimeve të shpeshta të ngjarjes dhe me frikë nga pasoja e mundshme që mund të ketë nga lëndimi. Pas kësaj frika kalon në frikë sekondare të intensitetit të ulët edhe dy muaj tjetër vijues me simptoma të lartëcekura por me intensitet më të ulët, por me mundësi ringjallje sa herë që flitet për ngjarje të ngjajshme traumatike.

Me leximin e provave: kuponi fiskal, i dt. 19.06.2019, nr. 2, i lëshuar nga Shërbimi Ambulator Neurokirurgjia, kuponi fiskal, i dt. 05.04.2019, i lëshuar nga "O..." NTP Njësia Ferizaj, kuponi fiskal id t. 31.05.2019, me numër 0010 i lëshuar nga P..." SHPK Ferizaj, kuponi fiskal nr. 0009 i dt. 31.05.2019, i lëshuar nga "P..." SHPK Ferizaj, kuponi fiskal i dt. 15.06.2019, i lëshuar nga "D..." NTP, në Ferizaj gjykata ka vërtetuar se paditësi ka bërë shpenzime mjekësore për shërim si pasojë e aksidentit 58.80 euro.

Duke u nisur nga kjo gjendje faktike gjykata ka nxjerrë përfundim se kërkespadija e paditësit I.R është pjesërisht e bazuar, sepse nga provat e administruara dhe faktet jokontestuese u vërtetua se me se me datën 31.03.2019 ka ndodhur një aksident i komunikacionit rrugor, të cilin e ka shkaktuar B.B, me përdorimin e automjetit të udhëtarëve "Mercedes" ML350, me targa të regjistrimit të Zvicrrës ... Kurse e paditura nuk e ka kontestuar legjitimitetin pasiv të sajë e as bazën juridike të kërkesëpadisë për sa i përket rrjedhës së ngjarjes deri te aksidenti. Kurse edhe në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia pala në këtë rast konkret për kompensim dëmi ka të drejtë të parashtroj kërkesë te e paditura.

Dhe si pasojë e këtij aksidenti paditësi I.R ka pësuar dhimbje fizike, frikë, dhe ka bërë shpenzime mjekësore në vlerë 58.80 euro, si dhe ka pësuar dëm material për shkak të dëmtimit të motoçikletës në vlerë prej 424.50 eur dhe kjo gjykatë ka marr për bazë edhe dispoziten e nenit 183 të LMD-së, së Kosovës në lidhje me nenin 136 të LMD-së së Kosovës, sa i përket dëmit jomaterial, kurse sa i përket dëmit material nenin 136 të LMD-së, të gjitha këto në lidhje me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

Sa i përket pjesës së kërkespadiës së paditësit I.R me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditësit I.R t'ia paguaj shumat: në emër të ndihmës së personit të tretë, shumën prej 100 euro, në emër të ushqimi të përforcuar, shumën prej 200 euro, në emër të shpenzimeve për rehabilitim fizi klimaterik, shumën prej 260 euro, në emër të

shpenzimeve mjekësore shumë prej 11.20 euro gjykata në këtë pjesë kërkespadin e paditësit e ka refuzuar sepse paditësi nuk ka arritur ta vërtetoi faktin me prova, se me të vërtetë kanë bërë hargjime në emër të dëmit sipas këtyre bazave.

Pjesa tjetër e kërkesëpadis së paditësit, e cekur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ka të bëjë me dëmin jo material për dhimbje fizike dhe frikë u vlerësua si tepër e lartë dhe si e tillë u refuzua, duke marrë parasysh edhe dispozitën e nenit 183 paragrafi 2 të LMD-së, së Kosovës.

Gjykata ka vlerësuar edhe kuponin fiskal nr.11, i datës 17.09.2019, mirëpo sipas qëndrimit të kësaj gjykate i njëjti nuk mund të ketë ndikim në këtë qështje, sepse ka të bëjë me shpenzime rreth vërtetimit të deklaratës të noteri H.I dhe nuk ka të bëjë me shpenzime mjekësore.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së së Kosovës.

Gjykata bazuar në dispozitat e neneve 452.5 454.1, 453.2 të LPK-së e ka detyruar të paditurën B.K.S që paditësit t'ia kompenzojë shpenzimet e procedurës, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar sa i përket shpenzimeve: për përfaqësimin e paditësit në seanca gjyqësore, për përpilim të parashtresave, edhe në tarifen e OAK-ut të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Me datë 24.01.2020

Gjyqtari : Burim Emërllahu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmes të kësaj gjykate.

